



GAZIDEDË
CUSTOMS & EXCISE CONSULTING

PREZANTIM MBI SHËRBIMET E KONSULENCËS DOGANORE DHE TË AKCIZËS

16 SHKURT 2023
TIRANË, SHQIPËRI

| | |
|--|---------|
| RRETH GAZIDEDE KONSULENCË DOGANORE & AKCIZE..... | Faqe 3 |
| RRETH BESAR GAZIDEDE..... | Faqe 4 |
| SHËRBIMET E KONSULENCËS DOGANORE & AKCIZËS..... | Faqe 5 |
| SHËRBIMET E KONSULENCËS DOGANORE & AKCIZËS - EKSPERTIZË..... | Faqe 6 |
| SHËRBIMET E KONSULENCËS DOGANORE & AKCIZËS - KËSHILLIM..... | Faqe 7 |
| SHËRBIMET E KONSULENCËS DOGANORE & AKCIZËS - ASISTENCË..... | Faqe 8 |
| SHËRBIME TIPIKE - RISHIKIM DIAGNOSTIKUES..... | Faqe 9 |
| SHËRBIME TIPIKE - ASISTENCË MUJORE..... | Faqe 10 |
| SHËRBIME TIPIKE - PROJEKTE SPECIFIKE..... | Faqe 11 |
| PSE NE?..... | Faqe 12 |
| DETAJET E KONTAKTIT..... | Faqe 13 |



GAZIDEDE
CUSTOMS & EXCISE CONSULTING

GAZIDEDE KONSULENCË DOGANORE & AKCIZE është emri tregtar i Besar Gazidede regjistruar me datë 1 Nëntor 2018 në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L82301001A, me adresë Rruga Sulejman Delvina, Sheshi Wilson, Tiranë, Shqipëri.

Ne ofrojmë ekspertizë, këshillim dhe asistencë ligjore, procedurale dhe praktike:

- në fushën doganore;
- në fushën e akcizës në import dhe prodhimin vendas;
- në fusha të tjera që lidhen me lëvizjen ndërkombëtare të mallrave si TVSH, Taksat Kombëtare etj.

Shërbimet tona janë të dedikuara për importuesit, eksportuesit, prodhuesit, tregtarët, postën e shpejtë, transportuesit, agjensitë doganore, individët etj.

Ne reduktojmë kompleksitetin e legjislacionit dhe e vendosim atë në shërbim të interesit më të mirë të Klientëve tanë, me qëllim realizimin e objektivave si optimizimi i detyrimeve dhe taksave të pagueshme; optimizimi logjistik; kryerja e formaliteteve në mënyrë eficiente, pa pengesa dhe në kohë sa më të shkurtër.



BESAR GAZIDEDE
KONSULENT DOGANOR & AKCIZE
GAZIDEDE KONSULENCË DOGANORE & AKCIZE

BESAR GAZIDEDE është diplomuar për Ekonomiks (2006-2010) pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, dhe ka zhvilluar një karrierë në fushën doganore & akcizës, në të cilën është specializuar thellësisht.

Është Themelues dhe Konsulent pranë Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize, ku ofron ekspertizë, këshillim dhe asistencë për llogari të kompanive të përfshira në tregtinë ndërkombëtare të mallrave dhe prodhues të mallrave të akcizës.

Besari këshillon dhe asiston kompani të mirënjohura ndërkombëtare dhe vendase që operojnë në sektorë të ndryshëm si ai energjetik (hidrokarbure), ushqimor, manufakturë dhe prodhim, importues eksportues, shoqata biznesi, dhoma tregtie etj.

Eksperienca e punës pranë sektorit publik dhe privat përfshin:

- 1 Nëntor 2018 - aktualisht, Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize si Konsulent;
- 2015-2018, PricewaterhouseCoopers Albania and Kosovo si Konsulent Doganor & Akcize;
- 2014-2015, Go Shipping Albania si Specialist për Import & Eksport;
- 2010-2014, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave si Specialist i Analizës së Riskut dhe Përgjegjës Sektori.

Konsulenca në fushën doganore dhe të akcizës është një praktikë e konsoliduar që synon dhënien e opinionit të ekspertit, dhënien e udhëzimeve dhe rekomandimeve bazuar në praktikat më të mira, dhe dhënien e asistencës në mbrojtje të interesit të Kompanive të përfshira në tregtinë ndërkombëtare të mallrave.

Tre shtyllat mbi të cilat mbështen shërbimet tona të konsulencës doganore dhe të akcizës janë:

EKSPERTIZË

Disponojmë kapacitetet dhe njohuritë e duhura mbi legjislacionin ndërkombëtar, Shqiptar dhe të Bashkimit Europian, në fushën doganore, akcizës, TVSH etj.

KËSHILLIM

Aftësitë profesionale dhe eksperiencia e punës na mundësojnë të ofrojmë udhëzime dhe rekomandime të kualifikuara, të personalizuar dhe të cilësisë së lartë, bazuar në praktikat më të mira.

ASISTENCË

Jemi të gatshëm dhe kemi mundësi të ndihmojmë dhe të suportojmë Klientët tanë, me qëllim mbrojtjen e interesit të tyre më të mirë.

Legjislacioni doganor & akcizës është kompleks dhe kërkon njohuri specifike për ta kuptuar dhe interpretuar.

Pse nevojitet ekspertiza jonë?

→ Opinioni ynë i ekspertit:

- Ju ndihmon të kuptoni kërkesat ligjore në raport me aktivitetin e biznesit tuaj në fushën doganore & akcizës;
- Ju ofron siguri për veprimtarinë tuaj;
- Ju jep mundësi të përmirësësoni proceset;
- Në shumicën e rasteve rezulton në kursim kohe, reduktim kostosh dhe eliminim të procedurave të panevojshme.

→ Ekspert në Gjykatë:

Bazuar në kërkesën tuaj, opinioni ynë mund të përbejë një element të rëndësishëm në vendimarrjen e Gjykatës për çështje që lidhen me fushën tonë të ekspertizës.

Kur nevojitet ekspertiza jonë?

- ✓ Nëse kërkon një opinion të kualifikuar lidhur me veprimtarinë doganore & akcizës të biznesit tuaj;
- ✓ Nëse jeni të interesuar të identifikoni fushat për përmirësim;
- ✓ Nëse dëshironi të siguroheni se nuk po paguani detyrime doganore & akcize të tepërta si pasojë e pasaktësive;
- ✓ Nëse procedurat tuaja doganore & akcizës janë shumë të komplikuar;
- ✓ Nëse dëshironi të siguroheni që keni përmbushur të gjitha detyrimet ligjore dhe të minimizoni ekspozimin ndaj shkeljeve dhe penaliteteve të cilat mund të rezultojnë nga një kontroll pas zhdoganimi (aposteriori) eventual, deri në 3 vite pas përfundimit të procedurave doganore;
- ✓ Nëse dëshironi të apeloni një vendim arbitrar të autoriteteve doganore;
- ✓ Nëse kërkon opinionin tonë si ekspert në gjykatë;
- ✓ Për gjithçka tjetër që lidhet me fushën tonë të ekspertizës.

Aftësitë profesionale dhe eksperiencia e punës me kompani lokale dhe ndërkombëtare që operojnë në sektorë të ndryshëm na mundësojnë të ofrojmë udhëzime dhe rekomandime të kualifikuara, të personalizuar dhe të cilësisë së lartë, bazuar në praktikat më të mira.

Shërbimet tona këshillimore mbulojnë të gjitha fushat e legjislacionit doganor, përfshirë:

- Deklaratat dhe formalitetet doganore;
- Vlera doganore, tarifa dhe origjina;
- Borxhi doganor dhe garancia;
- Përjashtimi nga detyrimet doganore;
- Procedurat (regjimet) doganore dhe procedurat e thjeshtuara;
- Kontrollet doganore, vendimet, shkeljet, sanksionet/penalitetet dhe apelimet;
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë;
- Licensat në import/eksport;
- Pronësia intelektuale në dogana etj.

Shërbimet tona këshillimore lidhur me akcizën përfshijnë:

- Regjimi i pezullimit të detyrimeve;
- Përjashtimi nga detyrimi i akcizës, humbjet dhe firot, rimbursimi;
- Nivelet e detyrimit të akcizës;
- Prodhimi, përpunimi dhe magazinimi i mallrave të akcizës;
- Garancitë;
- Mallrat e akcizës dhe klasifikimi fiskal;
- Kontrollet, vendimet, shkeljet, sanksionet/penalitetet dhe apelimet etj.

Në fushën e TVSH ne këshillojmë lidhur me:

- Fushën e zbatimit;
- Personat dhe transaksionet e tatueshme;
- Shkallët e TVSH, përjashtimet;
- Faturimi dhe skemat e veçanta, etj.

Në fushën e Taksave Kombëtare ne këshillojmë lidhur me:

- Taksën e rentës minerare;
- Taksën e ambalazheve dhe taksën e artikujve plastikë;
- Taksën e qarkullimit dhe të karbonit, etj.

Shërbimi ynë i asistencës është ndihma që ju nevojitet lidhur me çështje, procedura, transaksione etj. doganore & akcize, të cilat mund të kenë edhe implikime në TVSH, Taksa Kombëtare etj.

- **Ne ndihmojmë dhe suportojmë stafin tuaj** gjatë kryerjes së procedurave, formaliteteve, veprimeve, përgatitjes së kërkesave dhe apelimeve, duke u përfshirë aktivisht dhe drejtpërdrejtë me qëllim mbrojtjen e interesit tuaj më të mirë.
- **Ne kryejmë për llogari të biznesit tuaj** procedura, formalitete, veprime, ballafaqohemi me autoritetet doganore për llogarinë tuaj, hartojmë kërkesa dhe apelime, në mënyrë që stafi juaj të mbetet i fokusuar në biznes dhe pa shpenzuar kohë për çështje administrative të komplikuar.

Pse nevojitet asistenca jonë?

- Për të deleguar kompetenca tek ekspertë të fushës që mbrojnë interesin tuaj;
- Për të përforcuar kapacitetet teknike të stafit tuaj dhe për t'u krijuar mundësi të fokusohen në punën e tyre;
- Për t'ju suportuar gjatë ballafaqimit me autoritetet doganore, etj.

Fusha e asistencës doganore & akcize:

- ✓ Asistencë lidhur me vlerën, tarifën dhe origjinën;
- ✓ Përshpejtimi i formaliteteve të zhdoganimit të mallrave;
- ✓ Konceptimi dhe përgatitja e letrave, kërkesave dhe apelimeve për autoritetet doganore;
- ✓ Asistencë gjatë kontrolleve doganore pas zhdoganimit apo gjatë zhdoganimit, si dhe gjatë kontrolleve të akcizës;
- ✓ Përgatitja për autorizimet doganore & akcizës, aplikimi dhe ndjekja e procedurës së marrjes së tyre;
- ✓ Mbajtja e regjistrave të regjimeve doganore dhe kryerja e raportimeve periodike;
- ✓ Trainim i stafit tuaj lidhur me legjislacionin doganor & akcizës që impakton aktivitetin tuaj etj.



**RISHIKIM
DIAGNOSTIKUES**

Çfarë është?

Rishikimi diagnostikues është check-up i veprimtarisë së Kompanisë suaj në raport me legjislacionin doganor & akcizës.

Për llogarinë tuaj, ne analizojmë operacionet doganore & akcizës të Kompanisë, me qëllim identifikimin e pikave të forta, pikave të dobëta, fushave për përmirësim dhe evidentimin e rrezikut potencial, në raport me legjislacionin doganor & akcizës.

Pse nevojitet?

Shërben për të identifikuar gabimet sistematike të agjensisë doganore, të stafit të kompanisë etj. Shërben për të identifikuar fushat potenciale për përmirësim. Në shumicën e rasteve rezulton në kursim kohe, reduktim kostosh dhe eliminim të procedurave të panevojshme.

ASISTENCË MUJORE

Çfarë është?

Asistenca mujore është shërbimi ynë help-desk i cili ka si qëllim dhënien e informacionit, rekomandimeve, udhëzimeve dhe të asistencës, në varësi të çështjeve dhe problematikave që mund të lindin në fushën doganore & akcizës, përgjatë aktivitetit ditor të Kompanisë.

Pse nevojitet?

Ju shërben për të adresuar rastet në kohë reale, si edhe ju mundëson akses tek një ekspert doganor & akcize të cilit mund t'i drejtoheni në çdo kohë, për të papriturat e aktivitetit ditor të Kompanisë suaj.



**PROJEKTE
SPECIFIKE**

Çfarë janë?

Ne ju asistojmë të implementoni projekte dhe procedura, zbatimi i së cilave kërkon njohuri teknike dhe shqyrtimin në tërësi të legjislacionit doganor, si psh:


- Përgatitja për aplikim me qëllim marrjen e autorizimeve doganore & ackizës;
- Përgatitja për aplikim me qëllim marrjen e autorizimeve të Operatorit Ekonomik të Autorizuar dhe/ose të Zhdoganimit Lokal;
- Përgatitja për aplikim me qëllim marrjen e autorizimit të Eksportuesit të Miratuar etj.

Pse nevojitet?

Kodi Doganor dhe Ligji për Akcizat ofrojnë mjaft lehtësi, procedura dhe mundësi nga të cilat kompanitë mund të përfitojnë.

Përfitimi nga mundësitë që ofrojnë legjislacioni doganor & akcizës inician vetëm me kërkesë të palës së interesuar.

Ne ju ndihmojmë të identifikoni procedurat doganore & akcizës që janë në interesin tuaj më të mirë dhe ju ndihmojmë të plotësoni kërkesat e legjislacionit.



Kuptojmë.

Ne njohim principet dhe standardet që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare të mallrave, të cilat përbëjnë thelbin e legjislacionit doganor Shqiptar, Bashkimit European etj.



Interpretojmë.

Ne kemi eksperiencën, ekspertizën, aftësitë e duhura për të artikuluar dhe interpretuar legjislacionin doganor & akcizës, TVSH etj. në shërbim të biznesit tuaj.



Ofrojmë zgjidhje.

Ne vendosim kapacitetet analitike dhe qasjen tonë të orientuar drejt zgjidhjes në shërbim të interesit tuaj më të mirë.



GAZIDEDË
CUSTOMS & EXCISE CONSULTING

Rruga Sulejman Delvina
Sheshi Wilson, 1/1
Tiranë, Shqipëri

Email: info@gazidede.al
Mob: +355 69 405 0005
Web: <https://gazidede.al/>

